

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Merzi kërkon mbështetjen e partisë para testeve të reja zgjedhore në Gjermani
ADRESA	https://www.koha.net/bote/merzi-kerkon-mbeshtetjen-e-partise-para-testeve-te-reja-zgjedhore-ne-gjermani
BURIMI	koha.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 01:58:21 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 12:55:43 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	902b050ce5caf63aa52fb5382e67eef0b1a5c2fbc74e178fa8f0933ce6ca140e
TEKSTI	72d7299e478498a5395b11de6fef6449f9274076e75b20a84760a0690744274d
PAMJA	e6112f9f2b3d4bd11407cf045b77b956627c892dba8d5962f1e4d77a6c8dc62c

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	330e0d5648042bfd69fac35477be2caa7807a63dc53facb8001135ce750be5bb
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	b76c045c30cbbea9eae7a42cd456659a809b623ad6b8382f688578771e275bcf
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/330e0d5648042bfd69fac35477be2caa7807a63dc53facb8001135ce750be5bb>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Mbështete KOHËN. Ruaje të vërtetën

Kontribuo →

Letër lexuesit

BOTË

Merzi kërkon mbështetjen e partisë para testeve të reja zgjedhore në Gjermani



Foto: Associated Press

Përktheu: Flutura Gashi-Mehmeti



15 shtator 2026 14:55

Shpërndaje në:



Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalën tonë zyrtar në Viber

Konservatorët në pushtet në Gjermani kanë thirrur një takim të posaçëm për të dielën, ku pritet që drejtuesit e lartë të partisë të diskutojnë humbjet e fundit në zgjedhje dhe të shprehin mbështetje për kancelarin Friedrich Merz, i cili po përballet me vështirësi, ka thënë të martën për Reuters një burim brenda partisë.

Merzi po përballet me kritika në rritje nga brenda partisë, pas rezultatit të dobët të Kristian Demokratëve (CDU) këtë muaj në Saksoni-Anhalt, ku e djathta ekstreme, Alternativa për Gjermaninë (AfD), iu afrua sigurimit të një shumice absolute në zgjedhjet e landit.

Në nivel kombëtar, CDU-ja dhe partia e saj simotër bavareze, CSU-ja, po marrin 18% deri në 20% në sondazhe, shumë më poshtë se rezultati i tyre në zgjedhjet federale të vitit të kaluar dhe dukshëm pas AfD-së.

Besimi te kancelari është dobësuar gjithashtu brenda partisë së tij. Një sondazh i INSA-s gjatë fundjavës tregoi se shumica e mbështetësve të CDU-së nuk besojnë më se Merzi është personi i duhur për këtë detyrë, ndërsa 78% e publikut të gjerë u shprehën në të njëjtën mënyrë.

Sipas burimit, qëllimi i takimit të së dielës është koordinimi i reagimit të partisë ndaj dy votimeve të tjera që zhvillohen po atë ditë në landet Mecklenburg-Pomerania Perëndimore dhe Berlin, përcaktimi i një strategjie në kushtet e mbështetjes rekord të ulët dhe demonstrimi i unitetit pas drejtimit të Merzit.

Pas rezultatit të dobët në Saksoni-Anhalt, disa kritikë brenda CDU-së kanë thënë se një tjetër rezultat i dobët këtë fundjavë mund të shtojë presionin ndaj Merzit.

Duke folur të martën në një aktivitet me drejtues të biznesit, Merzi ka thënë se ishte i vendosur ta përfundonte mandatin e plotë katërvjeçar dhe të ndiqte reforma të tjera së bashku me partnerin e tij në koalicion, Partinë Socialdemokrate të qendrës së majtë (SPD), për të zgjidhur problemet e Gjermanisë.

Futboll.

Espí e shpëton Realin nga turpi

Arbëri.

Kurti: Shqiptarët e Luginës kanë nevojë për bashkëpunim e përgjegjësi të përbashkët

Arbëri.

Hehir: Turp i madh që një gjykatë e huaj që iu imponua Kosovës t'i shpallë fajtorë figurat e UÇK-së

Futboll.

Zyrtare: Lionel Messi ftohet nga Argjentina

Kulturë.

"Lufta nën akuzë..." demaskon rishkrimin e historisë së çlirimit

Futboll.

Liverpooli eliminon Tottenhamin nga Kupa e Ligës

Edhe



Botë • 9 sht 2026

**AfD-ja tallet me Merzin pas fitores:
Njerëzit e shkatërruan partinë tuaj**

“Duhet të dëshmojmë se kjo mund të arrihet me këtë koalicion”, ka thënë Merz, duke shtuar se nuk dëshironte t'i drejtohej një mocioni mosbesimi për të çuar përpara agjendën e tij.

CDU-ja aktualisht po merr 7% në sondazhe në Mecklenburg-Pomeraninë Perëndimore. Në Berlin, ajo është në krye së bashku me partinë e Majtë, me nga 20%.

Merzi ka hedhur poshtë përpjekjet për ta lidhur të ardhmen e tij politike me rezultatet e zgjedhjeve në lande të veçanta, duke argumentuar se Gjermanisë i duhet stabilitet për të çuar përpara një agjendë ambicioze reformash dhe për të përballuar sfidat evropiane, përfshirë aktet e luftës hibride dhe mbështetjen për Ukrainën.

#GJERMANIA

#FRIEDRICH MERZ

#ZGJEDHJET

Artikuj të ngjashëm



Botë • 9 sht 2026

**Merzi akuzon AfD-në për thirrje për
“spastrim etnik”**



Botë • 7 sht 2026

**AfD-ja synon të formojë qeverinë në
landin lindor të Gjermanisë pas fitores në
zgjedhje**



Botë • 7 sht 2026

**Merzi i tronditur nga fitorja e AfD-së:
Humbja më e rëndë në dekada**



Botë • 7 sht 2026

**Merzi në vështirësi pas fitores së parë të
një partie të ekstremit të djathtë që nga
epoka naziste**

KOHA

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohej kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësisë që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Marketing

Politika e privatësisë

Kushtet e përdorimit

Udhëzimet për përdorimin e IA-së

Cilësimet e privatësisë dhe cookies

Perkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!

+383 (0) 38 249 105 /

AL EN DE FR ES GR SR TR MK

Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh Bush p.n., 10000 Prishtinë

Shkarkoje aplikacionin e KOHËS



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.